

EKSTRAKT

MBI AUDITIMIN E KREYR NE AGJENCINË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT (AKPT) TIRANË

Në zbatim të programit të auditimit, të miratuar nga Ministri, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e MZHUT ka zhvilluar angazhim/ mision auditimi përputhshmërie, në AKPT Tiranë, për periudhën 01.01.2012-30.09.2013, me objekt zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë.

Grupi i auditimit ka përgatitur raportin final të auditimit dhe gjatë realizimit të këtij angazhimi janë konstatuar gjetjet e mëposhtme:

I. Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, rezultoi se, nga 11 rekomandime të dhëna, vetëm 1 është realizuar, kurse 10 rekomandimet e tjera nuk kanë gjetur zbatim, pasi lidhen me miratimin e rregullores së brendshme të AKPT, e cila ka mbetur si draft rregullore, e pa miratuar nga struktura e ngarkuar sipas VKM.

II. Nga verifikimi i përlllogaritjeve mbi pagat dhe shqyrtimi i procedurave të rekrutimit dhe emërimeve, plotësisë së dosjeve personale, (me zgjedhje) për periudhën Janar 2012 - Shtator 2013, u konstatuan mangësi dhe shkelje të VKM nr.355, datë 07.07.2000, "Për organizimin e dosjes dhe regjistrin të personelit". Efektet financiare të shkeljeve janë lënë për zhdëmtim.

III. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e Kreut III, pika 4 të VKM nr.1190, datë 13.11.2009, "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKPT", sepse është hartuar draft rregullorja, por nuk i është përcjellë Ministrisë së linjës dhe nuk ka miratim nga Kryeministri.

IV. Nga vlerësimi i procedurave të shkëputjes së marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për periudhën 2011-2013, rezultoi se kanë hapur proces gjyqësor 2 ish punonjës dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative të vendimeve gjyqësore, për personat e larguar nga institucioni, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe Udhëzimit të MF nr.4, datë 27.01.2011, "Për zbatimin e buxhetit të viti 2011", pika 6.1 "Vendimet Gjyqësore".

V. U konstatuan parregullsi në shpenzimet për dietat jashtë vendit në 3 raste, me një vlerë të përgjithshme prej 207.612 lekë.

VI. Mangësi dhe parregullsi në shpenzimet e kryera me objekt pritje- përcjelljet zyrtare

në shumën 175.710 lekë, pasi nuk është zbatuar VKM nr. 243, datë 15.05.1995, “Për shpenzimet për pritje përcjellje dhe për trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja” i ndryshuar.

VII. Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme

Gjatë vitit 2013, në institucion, janë kryer pagesa, në 3 raste, me objekt riparime elektrike, hidraulike dhe mirëmbajtje ndërtese, në shumën 1.392.818 lekë me TVSH. Nga auditimi i këtyre praktikave u konstatuan punime të pakryera, në vlerën 129.756 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, të arkëtueshëm. Gjithashtu rezultoi se:

-Nuk është zhvilluar tender për mirëmbajtje godine.

-Nuk ka kontratë të lidhur midis palëve për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet.

-Ka mospërputhje të zërave të punimeve midis procesverbalit dhe situacionit.

Si përfundim, veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe udhëzimeve të nxjerrë në zbatim të tyre. Rezulton se AKPT i është shmangur kësaj procedure, duke filluar nga planifikimi dhe miratimi e regjistrit të prokurimeve.

-